

2019-2020

MICS në Republikën e Kosovës

dhe

MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës

## Puna e fëmijëve




Anketa e Treguesve  
të Shumëfishtë

### Puna e fëmijëve: Nivelet dhe shpërndarja




#### Puna e fëmijëve për moshën 5-17 vjeçare: SDG 8.7.1

Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri 17 vjeçare të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas karakteristikave të përgjithshme

#### Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri 17 vjeçare të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas karakteristikave të përgjithshme

(R) Indeksi i pasurisë është ndërtuar duke përdorur informacionin mbi asetet e ekonomive familjare me supozimin se kjo reflekton pasurinë afatgjatë, duke i renditur ekonomitë familjare sipas pasurisë, nga më të varfërat te ato më të pasurat. Llogaritjet janë kryer veçmas në mostrën për MICS për Kosovë dhe mostrën për MICS me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, duke përdorur karakteristikat për secilën mostër përkatëse. Rezultatet e llogaritura të pasurisë pra janë të zbatueshme vetëm për të dhënat e veçanta në të cilat bazohen dhe ndryshojnë për dy anketat. Gjetjet sipas rezultateve të pasurisë të llogaritura për MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian tregohen me '(R)' në grafikon.

#### Përkufizimi i punës së fëmijëve

Mosha 5 deri 11 vjeç: Të paktën 1 orë aktivitete ekonomike ose 21 orë punë shtëpie pa pagesë në javë.

Mosha 12 deri 14 vjeç: Të paktën 15 orë aktivitete ekonomike ose 21 orë punë shtëpie pa pagesë në javë.


Mosha 15 deri 17 vjeç: Të paktën 43 orë aktivitete ekonomike. Nuk ka ndonjë prag për numrin e orëve për punë shtëpie të papaguara.

Aktivitetet ekonomike përfshijnë punën e paguar ose pa pagesë për dikë që nuk është anëtar i ekonomisë familjare, puna për fermën familjare ose biznesin. Punët e shtëpisë përfshijnë aktivitete të tilla si gatimi, pastrimi ose kujdesi për fëmijët.

Duhet pasur parasysh se përkufizimi i treguesit të punës për fëmijë ka ndryshuar gjatë implementimit të raundit të gjashtë të MICS. Ndryshimet përfshijnë pragjet specifike të moshës për punët e shtëpisë dhe përjashtimin e kushteve të rrezikshme të punës. Përderisa koncepti i përgjithshëm i punës së fëmijëve përfshin kushtet e rrezikshme të punës, përkufizimi i punës së fëmijëve i përdorur për raportimin e SDG-ve nuk e përfshinë atë.

## Llojet e punës së fëmijëve


### Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri 17 vjeçare të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas llojit të aktivitetit dhe moshës

Shënim: Këto të dhëna pasqyrojnë proporcionet e fëmijëve të përfshirë në aktivitete që janë në ose mbi pragjet specifike të moshës të përshkruara në katorrin e përkufizimeve.

### Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri 17 vjeçare të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas llojit të aktivitetit dhe moshës

Shënim: Këto të dhëna pasqyrojnë proporcionet e fëmijëve të përfshirë në aktivitete që janë në ose mbi pragjet specifike të moshës të përshkruara në katorrin e përkufizimeve.

## Mesazhet kryesore

- 5 për qind e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare të popullatës së përgjithshme dhe 7 për qind e fëmijëve të kësaj moshe që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë ishin të përfshirë në punën e fëmijëve.
- Nuk ka dallime të mëdha në shpërndarjen e punës së fëmijëve sipas karakteristikave demografike dhe socio-ekonomike.
- 4 për qind e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare në Kosovë janë të përfshirë në aktivitete ekonomike që janë në ose mbi pragjet specifike të moshës që klasifikohen si punë e fëmijëve dhe 2 për qind janë të përfshirë në punë të shtëpisë të përcaktuara si punë e fëmijëve. Përqindjet janë të ngjashme në mesin e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë (respektivisht 6 për qind dhe 1 për qind).
- Në mesin e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, pak më shumë djem përfshihen në aktivitete ekonomike të klasifikuara si punë e fëmijëve (8 për qind) sesa vajzat (3 për qind).
- 6 për qind e fëmijëve të moshës 5-17 vjeçare në popullatën e përgjithshme dhe 7 për qind e fëmijëve të kësaj moshe që jetojnë në komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian punojnë në kushte të rrezikshme pune.


## Pabarazitë në punën e fëmijëve



Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri 17 vjeçare të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas llojit të aktivitetit dhe sipas gjinisë


## Kushtet e rrezikshme të punës

### Kosovë




Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri në 17 vjeç që punojnë në kushte të rrezikshme, sipas karakteristikave të përgjithshme

### — Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri 17 vjeçare të përfshirë në punë të fëmijëve, sipas llojit të aktivitetit dhe sipas gjinisë

### Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë



Përqindja e fëmijëve të moshës 5 deri në 17 vjeçare që punojnë në kushte të rrezikshme, sipas karakteristikave të përgjithshme

Anketa e Treguesve të Shumëfishtë për Kosovë (MICS) dhe MICS me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë janë realizuar në 2019-2020 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si pjesë e programit global MICS. Mbështetja teknike u sigurua nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), me fonde të siguruar nga Ministria e Financave (MF), Qeveria e Luksemburgut, Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë (MFK), UNICEF, Ekipi i Kombeve të Bashkuara të Kosovës (UNKT), Fondi i Popullsisë i Kombeve të Bashkuara (UNFPA)

dhe UN Women. Qëllimi i këtij dokumenti të shkurtër informativ është shpërndarja e të gjeturave të përzgjedhura nga MICS 2019-2020 në Kosovë dhe MICS 2019-2020 me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë në lidhje me punën e fëmijëve. Të dhënat nga kjo përmbledhje mund të gjenden në tabelat PR.3.1, PR.3.2, PR.3.3 dhe PR.3.4 (të treguar me shkronjën 'R' për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në MICS për Kosovën) në Raportin e gjetjeve të anketës.

Pasqyrat tjera të shkurtra informative statistikore dhe Raporti i Gjetjeve të Anketës për këtë anketë dhe anketa të tjera janë në dispozicion në [mics.unicef.org/surveys](https://mics.unicef.org/surveys).